



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:181758

Datë: 19.09.2023

Numri i dokumentit: 04691321

PPP.nr.418/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbareme ndërmjet kreditorit M (I) M nga fshati T, Komuna I, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson M.K, avokat në P, kundër debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, Rr. “Luan Haradinaj” pn, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson Besim Mustafa, lidhur me çështjen përmbareme sipas titullit ekzekutiv - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega Istog, C.nr.20/16 të datës 06.05.2019, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit numër P.nr.164/23 i datës 23.06.2023, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Shpend Ahmetaj në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 19.09.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër Urdhrit për Lejimin e përmbaremit P.nr.164/23 i datës 23.06.2023, të lejuar nga Zyra Përmbareme – Përmbareuesi Privat Shpend Ahmetaj në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat Shpend Ahmetaj në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremit të kreditorit M (I) M, ka lëshuar Urdhërin P.nr.164/23, të datës 23.06.2023, me të cilin ka lejuar përmbaremitin në bazë të titullit ekzekutiv - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega Istog, C.nr.20/16 të datës 06.05.2019, i plotëfuqishëm me dt.12.05.2023 dhe i ekzekutueshëm me dt.30.05.2023, në bazë të të cilit është urdhëruar debitori që t’ia paguajë shumën prej 5,900.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dt.23.04.2019 e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 809.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme.

Kundër Urdhrit të lartëcekur për lejimin e përmbaremit, brenda afatit të paraparë ligjor, debitori ka paraqitur prapësim me datën 19.07.2023. Në prapësim pretendohet se debitori e kundërshton në tërësi

urdhri përbarimor P.nr.164/2023 të datës 23.06.2023, të lëshuar nga Përbaruesi Privat Shpend Ahmetaj si të parakohshëm, duke shtuar se pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC.nr.2890/19 të datës 12.05.2023, debitori ka ushtruar Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, ndërsa sipas pretendimeve të debitorit kemi të bëjmë me aktgjykimin me të cilën dëmtohet në masë të konsiderueshme pala debitore, e që shkaqet dhe arsyet janë elaboruar më gjerësisht në revizionin e ushtruar. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar Gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit i ushtruar kundër Urdhërit Përbarimor të lartëcekur dhe të shtyhet përbarimi deri në vendosje përfundimtare nga Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me revizionin e ushtruar.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 21.07.2023 ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilën ka theksuar se pretendimet në prapësim janë jo lëndore, të pabazuara dhe janë parashtruar me qëllim të zvarritjes së çështjes, duke shtuar se prapësimi nuk përmban asnjë nga arsyet e parapara me nenin 71 të LPP-së dhe si i tillë duhet të refuzohet si i pabazuar. Tutje ka theksuar se debitori në prapësim askund nuk e cekë se cilën dispozitë ligjore e ka shkelur Përbaruesi, përkatësisht cilën dispozitë ligjore nuk e ka zbatuar, duke shtuar se revizioni i parashtruar nga debitori nuk e ndalon përbarimin, për faktin se titulli ekzekutiv është i plotfuqishëm dhe i përbarueshëm. Bazuar në këto pretendime, ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit si i pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi urdhri përbarimor.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi është i pa bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 22 par.1 e LPP-së, përcakton llojet e dokumenteve në bazë të të cilave mund të caktohet përbarimi. Në nënpar 1.1 të këtij neni përcaktohet: *“Dokumente përbaruese janë: 1.1.vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese”*. Në këtë funksion, dispozita nga neni 23 par.1 përcakton se: *“Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit...”*. Në anën tjetër, dispozita nga neni 24 par.1, e cila i referohet përbarueshmërisë së vendimit, parasheh që *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”* Elementet të cilat duhet t'i përmbajë një dokument përbarimor janë të përcaktuara saktësisht në dispozitën e nenit 27 par.1 të LPP-së, ku parashihet: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.”*

Në rastin konkret, përbarimi është lejuar në bazë të titullit ekzekutiv - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega Istog, C.nr.20/16 të datës 06.05.2019, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit, në emër të kompensimit të dëmit jo material t'ia paguajë shumën prej 5,900.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga data 23.04.2019, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 809.00 Euro. Aktgjykimi në fjalë është vërtetuar sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2890/19, të dt.12.05.2023.

Gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës erdhi në përfundim se titulli ekzekutiv i lartëcekur - Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.20/16, i datës 06.05.2019, i përmban të gjitha tiparet e dokumentit përbarues dhe rrjedhimisht shërben si bazë për

caktimin e përmbarimit, ngase i plotëson kushtet ligjore në kuptim të dispozitave nga nenet 22 par.1 pika 1.1, 23 par.1, 24 par.1 dhe 27 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim ngase i njëjti është bërë i formës së prerë me datë 12.05.2023, respektivisht i ekzekutueshëm me datë 30.05.2023. Me dispozitën e nenit 21 parashihet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Pra, në rastin konkret aktgjykimi ka shërbyer si bazë për lejimin e përmbarimit.

Pretendimet e përfaqësuesit të debitorit përqendrohen në faktin se kundër aktgjykimit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi është ushtruar revizion pranë Gjykatës Supreme të Kosovës dhe mbi këtë bazë duhet të shtyhet përmbarimi deri në vendosje përfundimtare në procedurë kontestimore. Lidhur me një pretendim të tillë, kjo Gjykatë vlerëson se revizioni si mjet i jashtëzakonshëm i goditjes nuk mund të ketë efekt suspensiv mbi përmbarimin e një vendimi gjyqësor të pajisur me vulë të plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, e në kontekst të tillë, dispozita nga neni 213 e Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton se: *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*.

Gjykata me rastin e vendosjes po ashtu mori parasysh pretendimet e palës debitore se kemi të bëjmë me aktgjykim me të cilën dëmtohet në masë të konsiderueshme pala debitore, pretendime këto të cilat sipas Gjykatës i përkasin kontestimit lidhur me mënyrën e vendosjes në procedurë kontestimore, e si të tilla nuk mund t'i nënshtrohen vlerësimit nga ana e gjykatës në këtë procedurë. Procedura përmbarimore udhëhiqet nga parimi i rigozitetit formal, i cili e pamundëson shqyrtimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së vendosjes pranë instancave tjera, ngase objekt shqyrtimi është vetëm vlerësimi i dokumentit që ka shërbyer si bazë për lejimin e përmbarimit.

Nga arsyet e dhëna, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo Gjykatë gjeti se prapësimi i përfaqësuesit të debitorit është i pabazuar pasi që i njëjti nuk ka ofruar prova bindëse për t'i bërë të besueshme pretendimet e tij, andaj të njëjtin e refuzoi si të pa bazuar, duke vendosur devidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.418/23, datë 19.09.2023

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.